

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-7  
S 39

PAULIN S. SELIMI

6

NJË  
SKEÇ  
PËR  
VETEN

TREGIME  
HUMORISTIKE

B14-2  
559.

PAULIN SELIMI

# NJË SKEÇ PËR VETEN

*Tregime humoristike*



Shtëpia Botuese «Naim Frashëri»


SH-5

292

LIVIJI SERTIMI

# THE SECRET PERIOD

Tirazhi emri përmendje



Tirazhi 8000 kopje


Format 70 x 100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1977

## **TOGER BYLYKU DHE... KOBURJA**

Toger Bylyku, me mustaqe allafranga, djalë i vetëm i Lutfi bej Vërdhomës, arrii të shtinte në dorë gruan e prefektit, Xhizelën lozonjare me dhëmbë të vënë në Trieste.



Ajo e simpatizoi pér farefisin e pér mustaqet, kurse Bylyku e lakmoi pér trupin, dhëmbët e faqet.

Si ushtarak, toger Bylyku qe burrë i zoti. Dinte tē jepte pesë komanda pérnjéherësh, tē qëllonte pérpjetë, anash, në dritarë, pas krahëve, barkas, në raste alarmi ose dasme dhe tē lexonte katër paragrafe tē rregullores, pa ia bërë syri tërr.

Kishte shumë pasuri, gjithashtu edhe dy dekorata, njëren pér «triméri» në kohë paqeje dhe tjetërën pér besnikëri tē patundur ndaj Zogut, po gjëja më e shtrenjtë pér tē, pérveç femrave dhe pijes, ishte një kobure me dorezë argjendi. Kur pinte raki, koburen edhe mezen i kishte pérpara, kur rruhej, e varte në pasqyrë, kur kruhej ose në raste alarmi, e linte në zyrë, bile, nganjéherë, më shumë kohë i kushtonte kobures, sesa mustaqeve bojëtullë. Të gjithë ushtarët që kishte në vartësi, ia njihnin huqet dhe koburen, se shumë herë u matej me tē, si e pror që ishte, bile edhe kishte qëlluar kundër ushtar Qemalit, se ky ishte i pabindur.

Po natyra s't'i jep tē trija: mustaqe ngjyrëtullë, kobure dorezargjendtë dhe sy tē mprehtë...

...Atë ditë tē ngrrohtë korriku Bylyku doli tërë nerva dhe i shkopsitur nga zyra e komandës. Vuri dorën në veshin e djathtë dhe bërtiti aq fort, sa iu drodhën mustaqet dhe i nxori punë edhe një gomari, që po kulloste gjer atëherë i qetë në punë tē vet e që s'i binte ndër mend t'i përgjigjej kujt me tē pëllitura.

— Borizanin shpejt, he qen!

Erdhi vrapi, duke u zgërdhirë borizani.

— Bjeri borisë, alarm!

— Po s'e kam bo... bo-rinë, — u përgjigj boriza-

ni, jo nga frika, po se i merrej goja. (Thoshin se Bylykut ia bënte me qëllim).

— He, genat e qenit! Shpejt borinë!

Ushtarët u shpérndanë duke qeshur në kërkim të borisë dhe e sollën brenda... dy orësh.

«Ta, ta, ta, ti, ti, ti!», ushtoi boria.

Ushtarët u mblohdhën. Në rreshtin e parë ishte «i pabinduri», ushtar Qemali, djalë kovaçi.

— Të dashur ushtarë!, — ia nisi fjalimit Bylyku pa letër përpara.

— Urra!, — thirri ushtar Qemali.

— Urra!, — u përgjigjën të gjithë me thirrje të zgjatura.

Disa oficerë dhe nënoficerë dolën në dritare dhe ashtu, gjysmë të zhveshur, morën qëndrim «gatitu», pasi kujtuan se kishte ardhur ndonjë person me rëndësi lokale, apo kuadër i lartë ushtarak. Bile edhe vetë Bylyku e kishte humbur toruan aq shumë nga këto thirrje, sa tërë nerva i foli Qemalit:

— More mistrec! Pse lëshon britma pa komandë? Shprehe gëzim, me sa duket.

— Si urdhëron, toger Bylyku, çfarë kam përbrenda, e nxora jashtë.

— Pse??

— Është hera e parë që na thua «të dashur».

U dëgjua një zhurmë miratimi nga ushtarët.

— E pastaj?, — pyeti me ironi Bylyku, duke kruar veshët llapotë.

— Po, o do të na lësh shëndenë, o do të kemi ndonjë sihariq tjetër, — iu përgjigj shkurt Qemali.

— Mos do na lirojnë nga ush... ush.. ush... ushtria?, — pyeti borizani.

— Mylle gojën, edepsëz! Ka ndodhur një fat-keqësi e madhe natyrore.

- Ik, mor, e tmerrshmë!
- Do kemi luftë?
- Më e madhe.
- Do kemi përsëri supë pa yndyrë në darkë?, — pyeti Qemali.
- Jo, jo, më e madhe.
- Mos i ka ndodhur gjë lartmadhërisë së tij, Zogut të Parë?
- Rroftë Zogu, mbreti i parë!, — briti një kap-ter, të cilin se kush e gjuajti me një këpucë të vje-tër ushtarake turinjve.
- S'i ka ndodhur gjë lartmadhërisë së tij, por mua... Po ti, Qemal, pse s'nderon me dorë?
- Kam reumatizëm.
- Apo s'të pëlqen Zogu i Zogut, hë, qen i qe-nit! Mos fol, do të flas unë. Kur isha në «inspektim» mbrëmë (këtu Bylykut iu drodhën flegrat e hundës nga kënaqësia), (ushtarët e kuptuan)... më humbi...
- Sanija?
- Luiza?
- Arsyefa?
- Jo, jo, jo... por... — heshti pak. Nga karakolli dëgjohej zhurma e dominove. Ca lëkura shalqini e fiqsh dolën fluturimthi nga zyra e komandës. Pastaj vazhdoi:
- ... më humbi koburja dorezargjendtë. Kush e gjen, ka pesë ditë arrest... më falni, pesë ditë pushim dhe dy... racione supë.
- Çfarë supe, me yndyrë, apo...
- Nuk ka rëndësi cilësia, po sasia. Racione co-pë dy, ditë copë pesë dhe ushtarë që do të kontrollojnë copë pesë. Por në fillim do t'ju provoj shqisat. Dil ti i pari. Ik 30 metra larg dhe më thuaj se sa gishta

kam në dorë. Kujdes, ama! Vetëm te dora e gishtit,  
— dhe ngriti dorën lart.

— Pesë.

— Jo, ik ti! Tjetri!

— Katër.

— Bravo! Këtej.

I fundit kishte ngelur ushtar Qemali.

— Sa gishta kam?

— Tetë, — u përgjigj Qemali gjakftohtë.

— Si!? Tetë gishta në një dorë? Ku ka dorë me tetë gishta në rruzullin globosor?

— Posi s'ka. Ka oktapodhi.

— Pse po tallesh!, — i bërtiti tërë nerva Bylyku.

Ushtarët ia plasën gazit.

— Nuk tallem. I kam rënë shenjës.

— Çfarë shenje?! Nuk jemi në qitje, mistrec!

Unë nxora vetëm dy gishta, e ti më thaua tetë.

— Po ti vetë na the që t'i bëjmë sytë katër. Katër herë dy bëjnë tetë.

Bylyku pér disa çaste shtangu në vend, u mbërthyte mirë e mirë dhe e pyeti shpejt e shpejt:

— Po në demostratë, pse nuk qëllove?

— Po kishte dalë ylberi. Kur del ylberi, nuk mund të marr shenjë.

— Mirë, mirë. Boll, se më çmende! Tani, ju të pestë do t'ju shohim se në ç'shkallë gatishmërie luftarake e keni hundën. Afrohuni secili me radhë dhe do më thoni se çfarë ere më vjen.

— Erë peshku, — foli njëri.

— Erë këmbësh.

— Erë myk, — ia priti i katërti.

— Erë myshku, jo, erë qeni, përzier me parfum,  
— tha Qemali.

Bylyku s'i mori pér ters këto fjälë, se me të vërtetë mbante në zyrë një qen stani pér zburim.

— Dhe tani me vrap të gjeni koburen! Unë po ju pres. Kuzhina gati dy racionet e supës! Shkrues, pesëditëshin!

Ushtarët u larguan. Pas një çerek ore, rrëzë një plepi, gjetën koburen dhe një palë dhëmbë artificalë. Pasi pinë nga një cigare, shkelën dhëmbët me këmbë dhe, ashtu të pestë së bashku, e hodhën koburen në një kanal të ujërave të zeza.

— Edhe i zoti e ka vendin këtu, shokë, — tha me ton të sigurt Qemali.

## GJELI PLAK ME ZË TË BUKUR

Ditë e bukur, ditë pune. Nushi u zgjua më herët se kurrë. Në vend që të merrte kazmën apo lopatën, mori gomarin dhe qeshi. Gomari, sa e pa, pëlliti.

— Shët, mos bëj zë, hë, zog gomari!, — e shau Nushi. — Rri urtë, se do të shkojmë në qytet!

Fjala «qytet» ia çeli ftyrën. Ngarkoi një kosh me sallatë, dy fshesa dhe një gjel plak, që këndonte një herë në dy javë, disa kokrra vezë dhe doli në rrugë.

«C'po i nxjerr disa lekë sot në pazar, apo s'është edhe vapë e madhe, — mendoi me vete Nushi. — Pse, mor, të rri e të punoj në fshat, kur i kam të gjitha kushtet të bëj tregti në qytet?! Veç kam hall se mos më shohin shokët e brigadës dhe ma nxjerrin gomarin në «pension»....».

Nushi përrpara, gomari prapa. Herë gomari përrpara dhe Nushi prapa... Herë ndalej gomari, herë Nushi. Kështu ecën ca pa u ndier pranë arave të kooperativës, pastaj gomari u ndal dhe s'dëgjonte të ecët përrpara.

— Ec, hë qen, se po na shohin dhe na thahet salleta, na prishen vezët... A e kupton se janë vezë rike?!